



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 9, paragrafi 7 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10, datë 3 prill 2019, në takimin e mbajtur më 08 tetor 2020 miraton:

R R E G U L L O R E NR. 06/2020

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE PROKURORË TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurën e zgjedhjes së anëtarëve prokurorë të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
2. Procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KPK-së do të jetë i hapur, transparent, në përputhje me parimet e konkurrencës, objektivitetit, paanshmërisë, përfaqësimit adekuat gjeografik për anëtarët prokurorë, barazisë gjinore dhe shumetnicitetit.

Neni 2

Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- "KPK" nënkupton Këshilli Prokurorial i Kosovës.
"KZ KPK"nënkupton Komisioni Zgjedhor i KPK-së.
"ZKPSH" nënkupton Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.
"LKPK" nënkupton Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
"KPSH" nënkupton Kryeprokurori i Shtetit.

Neni 3

Parimet e përgjithshme dhe kushtet e procesit të zgjedhjes për anëtarë të KPK-së

1. KPK-ja siguron që procesi i zgjedhjes së anëtarëve prokurorë të KPK-së të mbështetet në parimet e konkurrencës, transparencës, paanshmërisë, objektivitetit, barazisë gjinore dhe shumetnicitetit.

2. KPK-ja siguron që përbërja e saj të jetë në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të barazisë gjinore dhe shumetnicitetit.
3. Zgjedhja e anëtarëve të KPK-së mbështetet në performancë të lartë profesionale, reputacion moral dhe integritet personal.

Neni 4

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve prokurorë në KPK

Kandidatët e interesuar për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit nuk mund të aplikojnë në qoftë se kanë të shqiptuar sanksion disiplinor në pesë vjetët e fundit, duke përfshirë qortimin dhe vërejtjen jopublike.

Neni 5

Përfaqësimi shumetnik dhe gjinor në KPK

1. KPK-ja do të sigurojë që përbërja e saj të reflektojë natyrën shumetnike dhe gjinore në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 4 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
2. Para shpalljes së konkursit, KPK-ja do të bëjë vlerësimet paraprake mbi nivelin e përfaqësimit shumetnik dhe gjinor.
3. Nëse ka aplikues nga komunitetet joshumicë ose të gjinisë femërore, KPK-ja do të angazhohet të sigurojë që në përbërjen e saj të ketë së paku një (1) anëtar nga komunitetet joshumicë dhe së paku tre (3) anëtarë të gjinisë femërore.

Neni 6

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve

1. KPK-ja merr vendim për shpalljen e zgjedhjeve për anëtarë të saj nga radhët e prokurorëve, së paku tre (3) muaj para përfundimit të mandatit të anëtarit të KPK-së.
2. Në rastet kur mandati i ndonjërit nga anëtarët e KPK-së pushon para përfundimit të mandatit të rregullt, KPK-ja do të marrë vendim dhe do të shpallë konkursin menjëherë. Procedura e zgjedhjes do të zhvillohet në afat sa më të shkurtër.
3. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve duhet të përmbajë udhëzime të veçanta për prokuroritë përkatëse, ku do të zhvillohen zgjedhjet, përfshirë datën, vendin dhe kohën e zgjedhjeve. Shpallja do të përfshijë edhe njoftimin për përbërjen e komisionit të themeluar sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje.

Neni 7
Mandati dhe përbërja e Komisionit Zgjedhor

1. KPK-ja themelon Komisionin Zgjedhor për zhvillimin e zgjedhjeve dhe njofton kryeprokurorët e prokurorive përkatëse me vendimin për themelimin e KZ të KPK-së.
2. KZ KPK përbëhet nga tre (3) anëtarë me përbërjen si në vijim:
 - 2.1. Një (1) anëtar joprokuror i KPK-së - Kryesues i KZ të KPK-së;
 - 2.2. Një (1) prokuror nga ZKPSH-ja dhe
 - 2.3. Një (1) zyrtar i Sekretariatit të KPK-së.
3. KPK-ja do të zgjedhë nga një zëvendës për secilin anëtar të KZ të KPK-së nga paragrafi 2 i këtij neni.
4. KZ i KPK-së do të ketë mandat për zbatimin e vendimit të KPK-së për zhvillimin e zgjedhjeve. KZ i KPK-së do t'i raportojë KPK-së për procesin zgjedhor.
5. KZ i KPK-së vlerëson nëse të nominuarit për anëtarë të KPK-së nga radhët e prokurorëve plotësojnë kriteret e parapara në nenet 8 dhe 9 të Ligjit të KPK-së.

Neni 8
Procedura e nominimit dhe votimit

1. KZ i KPK-së me pranimin e vendimit për fillimin e procesit zgjedhor do të bëjë përgatitjet e nevojshme për procesin e zgjedhjes.
2. Kryesuesi i KZ të KPK-së do të njoftojë kryeprokurorin përkatës për afatet dhe procedurat e tjera zgjedhore. Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse është i obliguar të njoftojë menjëherë të gjithë prokurorët me njoftimin e mësipërm të KZ të KPK-së.
3. Kandidatura për anëtar të KPK-së do t'i paraqitet me shkrim apo përmes postës elektronike KZ të KPK-së, më së largu tre (3) ditë nga dita e njoftimit të kryeprokurorit nga ana e KZ të KPK-së, sipas paragrafit paraprak të këtij neni.
4. Prokurorët që plotësojnë kushtet nga prokuroria përkatëse ku zhvillohen zgjedhjet kanë të drejtën të jenë të nominuar për anëtar të KPK-së.
5. Nëse KZ i KPK-së konstaton se ndonjë nga kandidatët e nominuar nuk i plotëson kriteret ligjore nxjerr vendim brenda pesë (5) ditëve nga mbyllja e afatit për aplikim për mospranim të kandidaturës së kandidatit të nominuar.

6. Kundër vendimit të KZ të KPK-së nga paragrafi paraprak i këtij neni, kandidati i pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në KPK brenda tre (3) ditëve nga dita e pranimit të vendimit.
7. KPK-ja do ta shqyrtojë ankesën në afat prej pesë (5) ditësh nga dita e pranimit të ankesës. Në rast se KPK-ja refuzon ankesën, respektivisht, nëse e aprovon, KPK-ja publikon listën përfundimtare të kandidatëve të nominuar për secilën prokurori.
8. Procesi i votimit fillon vetëm nëse janë të pranishëm më shumë se 51% të prokurorëve të prokurorisë përkatëse.
9. Secili prokuror nga prokuroria përkatëse ka të drejtë të marrë pjesë në votim, përfshirë prokurorët që janë me mandat të plotë në Këshill.
10. Prokurorët që janë transferuar për kohë të caktuar marrin pjesë në votim në prokurorinë ku janë të emëruar si prokuror.
11. Procedura e votimit për zgjedhjen e kandidatit për anëtarë të KPK-së duhet të jetë e fshehtë.
12. Lista votuese do të përmbajë emrat e kandidatëve të nominuar nga prokuroria përkatëse sipas rendit alfabetik.
13. Prokurorët duhet të votojnë vetëm një kandidat nga lista votuese.
14. Nëse dy apo më shumë kandidatë kanë numër të njëjtë të votave, votimi përsëritet vetëm për ata kandidatë. Nëse edhe pas herës së dytë, kandidatët marrin numrin e njëjtë të votave, zgjedhja bëhet me short.
15. Nëse KZ i KPK-së konstaton se përfaqësimi i tillë gjinor dhe etnik nuk është arritur sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, atëherë KPK-ja do të zbatojë rregullën sipas së cilës kandidatët femra apo kandidatët nga radhët e komuniteteve joshumicë që kanë numër më të lartë të votave në nivel të të gjitha prokurorive ku mbahen zgjedhjet, në proporcion me numrin e përgjithshëm të prokurorëve, zgjedhën me përparësi anëtarë të KPK-së. Në rast se kandidatët kanë vota të njëjta atëherë zgjedhja bëhet me short.
16. KZ i KPK-së pasi të sigurojë që në KPK është plotësuar përfaqësimi gjinor dhe etnik shqyrton rezultatet për anëtarët e tjerë.
17. Prokurori që siguron më së shumti vota nga lista votuese, zgjidhet anëtar i KPK-së nga prokuroria përkatëse.
18. Secila prokurori përkatëse zgjedhë nga një prokuror për anëtar të KPK-së.

19. Prokurorët e zgjedhur kanë të drejtë që në çdo fazë të tërhiqen nga zgjedhja për anëtarë në KPK.
20. Pas përfundimit të procesit zgjedhor, KZ i KPK-së ia përcjellë KPK-së një raport për procedurën e nominimit dhe zgjedhjes. Raporti do të përfshijë informatat si në vijim: shpalljen e fituesit, numrin e votave për secilin kandidat dhe procedurën e zhvilluar, përfshirë edhe çfarëdo procedure për votim të dytë, si dhe një përshkrim të detajuar për çfarëdo shkeljeje procedurale apo ankese nga palët e pranishme dhe rekomandimet nëse procedura duhet të përsëritet.
21. KPK-ja, bazuar në rekomandimin e KZ të KPK-së, mund të vendosë nëse procedura e nominimit dhe zgjedhjes duhet të përsëriten. Baza për një vendim të tillë duhet të jetë e arsyetuar.
22. KPK-ja mund të vendosë për anulimin e konkursit apo përsëritjen e procesit të votimit edhe pa rekomandimin e KZ të KPK nëse gjatë trajtimit të raportit apo informatave të tjera vlerëson se kandidatët e emëruar apo procesi i votimit nuk ka qenë në bazë të legjislacionit në fuqi. Një vendim i tillë duhet të arsyetohet.
23. Në rast se anulohet konkursi, rishpallja e konkursit dhe procedura për nominim do të zhvillohet sipas nenit 8 të kësaj rregulloreje.

Neni 9 Dispozitat kalimtare

Anëtarët aktualë të KPK-së kanë për detyrim që të përgatisin zgjedhjet për anëtarët e rinj të KPK-së, me qëllim të ruajtjes së funksionalitetit.

Neni 10 Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja 02/2015 për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Rregullorja 06/2017 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 02/2015 për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kjo rregullore hynë në fuqi pas miratimit nga KPK-ja.

Prishtinë, më 08 tetor 2020

Bahri Hyseni



Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës